



**Republika e Kosovës**

**Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit**

**Përmbledhje Ekzekutive**

*Korniza e Politikave të Zhvendosjes*  
**(KPZH)**

**Projekti:**

**Projekti për Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme për Kapitalin Njerëzor të Kosovës**

**Projekt ID: P179656**

**Tetor, 2023**

## **Përmbledhje Ekzekutive – Korniza e Politikave të Zhvendosjes (KPZH)**

### ***Hyrje***

*Qeveria e Kosovës (QK) përmes Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve synon të marrë fonde nga Banka Botërore (BB) për zbatimin e Projektit për “Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme për Kapitalin Njerëzor të Kosovës”. Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i qasjes dhe cilësisë së shërbimeve të zhvillimit të fëmijërisë së hershme në Kosovë. Projektin për Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme (ZHFH) për Kapitalin Njerëzor të Kosovës është i strukturuar për t’iu përgjigjur çështjeve kryesore të shërbimeve të zhvillimit të fëmijërisë së hershme në Kosovë. Projektin do të ndihmojë Kosovën të përmirësojë aksesin, cilësinë dhe barazinë në ZHFH, si dhe të mbështesë shërbimet e kujdesit shëndetësor në adresimin e sfidave shëndetësore të fëmijëve në vend. Projektin gjithashtu do të shqyrtojë aktivitetet promovuese në ZHFH me qëllim që të rrisë ndërgjegjësimin e popullatës për rëndësinë e ZHFH në kuadër të shëndetit dhe zhvillimit të fëmijëve, duke sjelle si rezultat një prindërim më të mirë, identifikim të hershëm dhe ulje të shkallës së vdekshmërisë së fëmijëve. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) është agjencia kryesore zbatuese për përgatitjen e projektit dhe aktivitetet e përkatëse, dhe do të identifikojë kërkesat e menaxhimit mjedisor dhe social për fazën përgatitore të projektit.*

### ***Përshkrimi i Projektit dhe Komponentëve të tij***

*Objektivi i zhvillimit të projektit për ZHFH, është përmirësimi i qasjes së barabartë dhe rritja e cilësisë së shërbimeve të zhvillimit të fëmijërisë së hershme në Kosovë. Rezultatet kryesore të pritura nga zbatimi i projektit do të vlerësohet nga indikatorët që përbëhen nga:*

***Indikator 1:*** Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të edukimit në fëmijërinë e hershme – të kategorizuara sipas llojit të institucionit urban/rural

***Indikator 2:*** Rregullore të përmirësuara për sigurimin e cilësisë së shërbimeve të fëmijërisë së hershme në Kosovë

***Indikator 3:*** Përqindja e fëmijëve të vlerësuar sipas programit/mjetit kombëtar të zhvillimit dhe monitorimit të fëmijëve

***Indikator 4:*** Rritja e çasjes në shërbimet e kujdesit për fëmijët: shkalla e regjistrimit për fëmijët 0-6 vjeç – e ndarë sipas gjinisë, moshës, grupit të pakicës

*Projektin i propozuar do të organizohet rreth katër komponentëve kyç që kanë të bëjnë me përmirësimin e çasjes, cilësisë, barazisë dhe koordinimit ndër-sektorial të shërbimeve për ZHFH. Komponenti i parë do të forcojë cilësinë dhe barazinë e shërbimeve për ZHFH dhe kujdesin ndaj fëmijëve në Kosovë. Komponenti i dytë do të kontribuojë në përmirësimin e disponueshmërisë së shërbimeve shëndetësore dhe ushqimore për fëmijët dhe familjet në Kosovë. Komponenti i tretë do të fokusohet në rritjen e aksesit në ZHFH dhe kujdesin ndaj fëmijëve. Komponenti i katërt do të mbështeste menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e projektit.*

*Komponentët e projektit do të kenë një ndikim në nivel kombëtar dhe në nivel shkollor. Komponentët 1 dhe 2 do të kenë një shkallë mbarëkombëtare duke reformuar qasjen ndaj kujdesit të fëmijëve dhe shërbimeve për ZHFH, duke ndërtuar kapacitetet institucionale dhe njerëzore të vendit. Komponenti 3 do të ketë ndërhyrje në nivel shkolle duke ndërtuar, rinovuar dhe ripërdorur hapësira për të zgjeruar aksesin për ciklin parashkollor në të gjithë vendin. Komponenti 4 do të ndihmojë në ndërtimin e kapaciteteve eksperte të Kosovës në menaxhimin e projekteve dhe kryerjen e hulumtimit, monitorimit dhe vlerësimit.*

### **Komponenti 1: Forcimi i cilësisë dhe barazisë së shërbimeve për ZHFH në Kosovë.**

- ✓ Nën komponenti 1.1 Reformat e cilësisë në ZHFH në Kosovë
- ✓ Nën komponenti 1.2. Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për ZHFH
- ✓ Nën komponenti 1.3. Implementimi i modulit ECE për Sistemin Informativ të Menaxhimit të Arsimit (EMIS) në Kosovë dhe rishikimi i përgjithshëm i sistemit bazë EMIS.

### **Komponenti 2: Nxitja e integritit shumë-sektorial në ofrimin e shërbimeve për ZHFH**

- ✓ Nën komponenti 2.1. Stimulimi i hershëm dhe promovimi i ushqyerjes së shëndetshme
- ✓ Nën komponenti 2.2. Monitorimi i fëmijëve dhe integrimi ndërsektorial i shërbimeve

### **Komponenti 3: Rritja e aksesit në shërbimet e ZHFH**

- ✓ Nën komponenti 3.1. Ripërdorimi, ndërtimi dhe rinovimi i objekteve parashkollore dhe të ZHFH në Kosovë
- ✓ Nën komponenti 3.2. Pajisja e qendrave për ZHFH me mobilje dhe materiale të reja mësimore
- ✓ Nën komponenti 3.3. Mbështetje për pjesëmarrjen e komunitetit dhe ndërhyrjet nga ana e kërkesës

### **Komponenti 4: Menaxhimi, monitorimi dhe vlerësimi i projektit**

## ***Vendndodhja dhe shtrirja e projektit***

*Projekti i propozuar ka mbulim në nivel kombëtar dhe përfshin kufijtë administrativë të Republikës së Kosovës. Vendndodhja për ndërtimin e kopshteve të reja nuk janë caktuar ende në këtë fazë paraprake dhe do të detajohet pasi projekti të fillojë implementimin, gjithsesi pritet që ndërtimi i kopshteve të reja të bëhet kryesisht në toka publike, të cilat janë caktuar për këtë qëllim sipas planeve të zhvillimit dhe janë në pronësi, ose i janë transferuar përfituesit përkatës.*

## ***Qëllimi dhe Parimet e Kornizës së Politikave të Zhvendosjes***

*Qëllimi i dokumentit KPZH është të ofrojë politika dhe procedura për të shmangur dhe minimizuar nevojat e projektit për të përvetësuar toka me pronësi private dhe si rezultat mos të ketë ndikime në humbjen e të ardhurave të palëve që mund të preken. Dokumenti është hartuar në përputhje të plote me rregullat dhe politikat e BB, konkretisht me Standardin ESS5, për blerjen e tokës, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosjen e pavullnetshme, si dhe në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret që aplikohen në qeverinë e Kosovës. KPZH-ja është përgatitur sepse në këtë fazë, gjurmët e investimeve që do të financohen në kuadër të komponentin 3 të Projektit, nuk janë përcaktuar ende, dhe rrjedhimisht shkalla dhe shtrirja e saktë e ndikimit, mund të vlerësohet vetëm gjatë zbatimit të projektit. Një Plan Veprimi për shpronësimin/Risistemimin /Plani i Shkurtuar i Veprimit për Shpronësim/Zhvendosje do të përgatitet në përputhje me dispozitat e kësaj KPZH-je dhe do të dorëzohet Bankës Botërore për miratim paraprak, sipas rastit.*

Në përgjithësi, nënprojektet duhet të hartohen dhe zbatohen në mënyrë të tillë që të shmangin dhe minimizojnë humbjen e asetëve private. Ndikimet e pashmangshme duhet të trajtohen me masa zbutëse që do të jenë të mjaftueshme për të rikthyer nivelin e jetesën të personave të prekur, në nivelin që ishte para zbatimit të projektit. Njerëzit e prekur duhet të konsultohen në mënyrë adekuate në mënyrë domethënëse dhe të marrin pjesë në zhvillimin dhe zbatimin e masave zbutëse.

- Zgjidhja e mospërputhjeve apo boshllëqeve ndërmjet ligjeve të Kosovës dhe ESS 5 të Bankës botërore:

Në rast të ndonjë zbrastëtie apo mospërputhjeve ndërmjet kornizës ligjore të Kosovës dhe Standardeve të Bankës Botërore për Zhvendosjen e Pavullnetshme, dispozitat e kësaj KPZH-je do të jenë pjesë e marrëveshjes ndërkombëtare të nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës. dhe Banka Botërore.

### **Vlerësimi paraprak i Ndikimit**

Ndikimi social i projektit në këtë fazë vlerësohet të jete I mesëm. Duke pasur parasysh faktin se projekti do të financojë punimet e ndërtimit që lidhen me rehabilitimin dhe ripërdorimin e hapësirave ekzistuese si dhe ndërtimin e kopshteve të reja, si dhe faktin që vendndodhjet e ndërtimeve të reja nuk dihen ende, ESS5 është relevante, dhe MASHTI pritet të ndjekë udhëzimet e kësaj KPZH për të udhëhequr projektin në trajtimin e blerjes së tokës, kufizimeve për akses, ose çdo zhvendosje ekonomike dhe/ose fizike.

Komponenti 3, konkretisht nenkomponenti 3.1 është i vetmi që përfshin ndërhyrjet dhe punimet e ndërtimit, në formën e ndërtimeve të reja, rinovimeve, zgjerimeve, rikonstruksioneve apo transformimeve të hapësirave dhe ndërtesave ekzistuese. Prandaj, vetëm nën këtë Komponent mund të ketë ndikime të lidhura me risistemimin dhe nevojës për përvetësimin e tokës.

Komponentët 1,2 dhe 4 nuk kanë gjasa të kenë ndikime të zhvendosjes/marrjes së tokës pasi nuk përfshihen punime të ndërtimit. Megjithatë, parimet në lidhje me zhvendosjen e paraqitur në këtë KPZH zbatohen në të gjitha fazat e Projektit dhe nëse ndodh ndonjë rast zhvendosjeje dhe ndikimi negativ social, zbatohen rregullat e KPZH-së. Në mënyrë që kjo e fundit të mos ketë nevojë të përsëritet çdo herë.

Parashikohet që pjesa më e madhe e punimeve rehabilituese në kuadër të projektit për ZHFH do të kryhen brenda kufijve të zonave në pronësi publike. Rehabilitimi dhe ripërdorimi i hapësirave ekzistuese do të projektohet me kujdes në mënyrë që të përjashtohet sa më shumë kryqëzimi me pronat private. Ndërtimet e reja priten të ndodhin kryesisht në toka publike, të cilat janë caktuar për këtë qëllim dhe janë në pronësi, ose i janë transferuar përfutuesit përkatës. Me masat paraprake të sipërpërmendura, një shkallë e vogël e ndikimeve të përkohshme/të përhershme të blerjes së tokës mund të ndodhë gjatë punimeve të ndërtimit. Ndikimet e zhvendosjes nuk do të ndodhin sipas vlerësimit paraprak të projektit, gjithsesi në rast se do të ketë, do të shmangen dhe minimizohen në masën e mundshme.

Metodologjia për përzgjedhjen e projektimit të investimeve të propozuara dhe vendndodhjeve specifike të kantierit do të analizohet me kujdes nga ekipi teknik i projektimit dhe do të konsultohet me planet përkatëse vendore dhe bashkitë përfutuese, në mënyrë që të shmangët sa më shumë që të jetë e mundur kryqëzimi me pronat/asetet private. Përzgjedhja e kantierëve të ndërtimit sipas Projektit do të diskutohet dhe bihet dakord me Bankën Botërore përpara fillimit të punimeve të ndërtimit.

### **Procesi i Planifikimit të Shpronësimit:**

Zbatimi i aktivitetëve të projektit, (sipas komponentit 3 dhe nenkomponentit 3.1), mund të kërkojë blerjen e tokës. Në këtë rast, Planet e Veprimit të shpronësimit duhet të përgatiten në përputhje me këtë Kornizë të Politikës së Zhvendosjes (KPZH), përmes hapave të mëposhtëm:

- *Survejim Social*
- *Censusi, data e përfundimit dhe analiza socio ekonomike*
- *Përgatitjen e planit te veprimit për shpronësim*
- *Miratimin e planit te veprimit për shpronësim*
- *Implementimi I planit te veprimit për shpronësim*

## **Metodologjia e vlerësimit**

**Toka:** *Metoda e vlerësimit për kompensimin duhet të marrë parasysh të gjitha burimet e disponueshme të informacionit në mënyrë që vlera e propozuar për kompensim të pasqyrojë vlerën e tregut / vlerën e zëvendësimit të tokës. Supozimet kryesore që duhen marrë në konsideratë në kornizën metodologjike mund të lidhen me kuadrin aktual rregullator për shpronësimin e tokës dhe ndryshimet e tij të fundit; analiza financiare mbi rrjedhën e të ardhurave neto në lokacione dhe lagje; transaksionet eventuale (shitjet dhe dhëniet me qira) në rajon.*

**Ndërtesat:** *Vlera e banesave, strukturave komerciale dhe strukturave të tjera të prekura (të tilla si gardhet etj...) do të vlerësohen me vlerë zëvendësuese bazuar në llojin e ndërtimit, koston e materialeve, fuqinë punëtore, transportin dhe të tjera. Gjate vlerësimit, nuk do të aplikohet asnjë zbritje për amortizimin dhe koston e transaksionit. Për ndikimin e pjesshëm (nëse humbja është më pak se 15%), paguhet kompensimi për vlerën e zëvendësimit të strukturave të ndikuara. Vlerësimi do të përfshijë gjithashtu koston e aksesit në furnizimin me ujë nëse struktura e zhvendosur kishte akses ose nëse lokacioni i zëvendësimit nuk ofron akses.*

**Të mbjellat dhe pemët:** *Produktet e agrikulturës (Te mbjellat apo pemët) qe do te duhet ti nënshtrohen marrjes nga projekti, do të vlerësohen sipas metodologjive të ndryshme në varësi të përdorimit te tyre.*

## **Konsultimet me palët e prekura**

Për të siguruar që interesat e personave të prekur të përfshihen plotësisht në procesin e shpronësimit dhe rikthimin e të ardhurave, gjatë përgatitjes së nënprojektit do të kryhet një *konsultim* i plotë me personat e prekur, përfaqësuesit e çdo grupi të prekur, çdo grupi të interesuar dhe departamentet e ndryshme administrative dhe qeveritare.

## **Mekanizmat e Ankesave:**

*Nën drejtimin e specialistëve socialë të NjZP, mekanizmi i ankesave do të bëjë çdo përpjekje për të arritur një zgjidhje miqësore të të gjitha ankesave të ngritura për nënprojektet përkatëse. Ankuesit mund t'i dërgojnë ankesat e tyre përmes postës elektronike, letrave ose telefonatave. Lejohet paraqitja anonime e ankesave. Mekanizmi ankesave do t'u përgjigjet ankuesve me shkrim brenda 10 ditëve nga marrja e ankesës. Nëse kjo përpjekje dështon, do të organizohet Komiteti i Trajtimit të Ankesave për të diskutuar ankesat dhe për të identifikuar zgjidhjet që janë në përputhje me ligjet kombëtare dhe këtë KPZH. Nëse ankuesit ende nuk janë të kënaqur, ata janë të lirë të paraqesin një çështje gjyqësore për të kërkuar një zgjidhje.*

### ***Procedurat dhe organizimi i zbatimit.***

*MASHTI ka përgjegjësinë përfundimtare për zbatimin e të gjithë komponentëve të projektit së bashku me NjZP. Një komitet i përbërë nga Autoritetet e Projektit dhe palët e prekura do të krijohet për të qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të PVZH-së. NjZP do të planifikojnë dhe organizojnë vizitat në terren të bazuara në planet e shpronësimeve, kontrollet e historikut dhe të dhënat e marra nga komunat dhe institucione të tjera. Gjithashtu do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet vendore për të siguruar një zbatim të suksesshëm të planeve të shpronësimeve.*

### ***Programi i Monitorimit:***

*MASHTI dhe NjZP janë përgjegjës kryesore për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të kësaj KPZH-je dhe të planeve të veprimit për shpronësim përkatëse në nivel nënprojekti, dhe do t'i raportojnë Bankës Botërore performancën e zbatimit të KPZH-së përmes progresit të rregullt të projektit. Standardet specifike të monitorimit do të jenë:*

- *Fushata informative dhe konsultimi i realizuar;*
- *Statusi i marrjes së tokës dhe pagesave për kompensimin e tokës;*
- *Kompensimi për strukturat dhe asetet e tjera të prekura;*
- *Zhvendosja e personave të prekur, nëse ka;*
- *Kompensimet për humbje të të ardhurave;*
- *Përzgjedhja dhe shpërndarja e sipërfaqeve të tokës zëvendësuese, nëse është e nevojshme;*
- *Aktivitetet e ri-sistemimit*
- *Ankesat dhe zgjidhja e tyre*